



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2023:034146

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05493820

P.nr.76/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA LEPOSAVIQ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me zyrtare ligjore Doruntina BEKA, në çështjen penale kundër të pandehurit: S....S...., për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2339/22, të datës 31.01.2023, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.297/24, të datës 21.03.2024, të lidhur në mes të pandehurit S....S.... dhe të dëmtuarit Z...N...., jashtë seancës, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje si: KPP) dhe nenit 2 paragrafi 2, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), me datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.297/24, e datës 21.03.2024 e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mes palëve: të pandehurit S....S.... dhe të dëmtuarit Z...N....
2. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2339/22, të datës 31.01.2023, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: S....S...., nga i ati J...., i lindur me datë 01.03.1989 në Novi Pazar, me vendbanim në fshatin S.... Rr. "...", Leposavic, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës për veprën penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.
3. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.2339/22, të datës 31.01.2023, kundër të pandehurit S....S...., për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datën 21.03.2024, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.Nr.297/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit S....S.... dhe të dëmtuarit Z...N.....

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 paragrafi 2 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit.

Bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 22.03.2024 do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës së ndërmjetësimit, siç konstatohet në marrëveshjen e ndërmjetësimit i ka bartë i pandehuri S....S....

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA LEPOSAVIQ

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.76/23, datë 22.03.2024

Gjyqtari

Xhemajl JUSUFI

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tri (3) ditësh nga pranimi i tij, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.